



British Embassy
Pristina



NENI 17 I KONVENTËS SË STAMBOLLIT



Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
Association of Journalists of Kosovo

NENI 17 I KONVENTËS SË STAMBOLLIT

Konventa e Stambollit është një traktat i Këshillit të Evropës që kundërshton dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje. Qëllimi kryesor i saj është të parandalojë dhunën, të ofrojë ndihmë për viktimat dhe që të ndalojë pandëshkueshmërinë e autorëve të dhunës me bazë gjinore. Emri i plotë i traktatit është Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, dhe u hap për nënshkrim në maj, të vitit 2011. Ajo është nënshkruar nga 45 shtete të Këshillit të Evropës. Edhe pse nuk është anëtare e Këshillit të Evropës, Kosova e ka integruar Konvetën e Stambollit në Kushtetutën e Kosovës, në qershor të vitit 2020. Konventa e përshkruan dhunën ndaj grave si shkelje të të drejtave të njeriut dhe formë diskriminimi. Shtetet që e kanë miratuar zotohen të kriminalizojnë disa lloj shkeljesh, duke përfshirë: dhunën seksuale, që përfshin dhunimin, duke përmendur çdo lloj përfshirje në akte seksuale pa pëlqim; martesat me dhunë, synetinë e organeve gjentiale të grave, abortin e detyruar apo sterilizimin me forcë; si dhe çdo lloj krimi ndaj grave në emër të “nderit”. Neni i 17 flet për angazhimin e sektorit privat dhe medias për të punuar kundër dhunës ndaj grave. Ky është teksti i plotë:

Pjesëmarrja e sektorit privat dhe medias

1. Palët duhet të inkurajojnë sektorin privat, sektorin e teknologjisë informative dhe të komunikimit si dhe median, duke respektuar lirinë e shprehjes dhe pavarësinë e tyre, që të marrin pjesë në elaborimin dhe zbatimin e politikave, të krijojnë udhëzues dhe standarde vetërregulluese për të parandaluar dhunën kundër grave dhe për të përforcuar respektimin e dinjitetit të tyre.

2. Palët duhet të zhvillojnë dhe promovojnë, në bashkëpunim me akterët e sektorit privat, aftësi të reja për fëmijët, prindërit dhe edukatorët se si të ballafaqohen me mjedisin informativ dhe të komunikimit që ofron qasje në përmbajtje degraduese të natyrës seksuale ose të dhunshme, e që mund të jetë e dëmshme.

Neni 17 i Konventës së Stambollit e inkurajon sektorin privat që të ofrojë një ambient të përshtatshëm të punës për gratë, dhe të kujdeset për ruajtjen e integritetit të tyre fizik gjatë gjithë kohës. Teksti i Nenit 17 gjithashtu i referohet fuqisë së medias për të dhënë kontribut në parandalimin dhe denoncimin e dhunës ndaj grave. Media mbanë përgjegjësi gjithashtu për përmbajtjen që ofron, dhe duhet kujdesur që të mos ofrojë hapësirë për imazhe, video apo tekst që mund të mbështesin në çfarëdo forme dhunën ndaj grave. Sipas shpjeguesit të Konventës së Stambollit, qëllimi kryesor është që të inkurajohet një përfshirje e gjerë e kompanive të ndryshme të sektorit privat, me qëllimin e përbashkët të dhënies fund të dhunës me bazë gjinore.



Neni 17 gjithashtu parasheh që kontributi potencial i medieve për të ndaluar dhunën në bazë gjinore, nuk mund të cenojë lirinë e shprehjes dhe as pavarësinë editoriale që mediat e gëzojnë, sipas standardeve ndërkombëtare të medias së lirë. Një pjesë e Nenit 17 i referohet Internetit, si një koncept i gjerë që përfshin forma të ndryshme të komunikimit online, me theks të veçantë mediat sociale. Shumë shpesh, të rinjtë duke përfshirë vajza, targetohet nëpërmjet formave të ndryshme të bullizimit, që përfshin edhe shantazhet seksuale.

Mediat gjithashtu inkurajohen që ta bëjnë vendet e tyre të punës të përshtatshme për gratë, duke parandaluar ngacmimet seksuale. Sipas një sondazhi të Fundamental Rights Agency të vitit 2014, 45 deri 55 % e grave në Bashkimin Evropian kanë raportuar se kanë përjetuar një lloj të ngacmimit seksual në vendin e tyre të punës. Ngacmimet seksuale në vendin e punës, përveç viktimës, mund të afektojë edhe të tjerë punonjës të të dyja gjinive, që mund të provojnë të ndihmojnë ose që janë dëshmitarë të ngacmimeve. Për më tepër, ndikon në një ambient pune që duhet të jetë i përshtatshëm dhe i barabartë për të gjithë. Media mund të kontribuojë në ndryshimet shoqërore duke promovuar zero tolerancë për dhunën ndaj grave. Në raportimet e tyre, ato duhet të kujdesen që të ofrojnë hapësirë të barabartë raportimi si për burrat ashtu edhe për gratë, dhe të përmbahen nga përdorimi i gjuhës që përfshinë stereotipe gjinore.